

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 09 TETOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODŽANE 9. OKTOBRA 2003. GODINE

TETOR – OKTOBAR
2003



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

MEMORENDUM ZYRTAR

СЛУЖБЕНИ MEMORENDUM

PER/ЗА/TO	Deputetët e Kuvendit Посланике Скупштине Members of the Assembly	DATA ДАТУМ DATE	07 Tetor 2003 07 Октобар 2003. година 07 October 2003
NGA/ОД/FROM	Isuf Demaj Sekretar i Kuvendit / Секретар Скупштине / Secretary to the Assembly		
SUBJEKTI ПРЕДМЕТ SUBJECT	Mbledhja e Kuvendit / Заседање Скупштине / Meeting of the Assembly		

Mbledhja e ardhshme e Kuvendit do të mbahet :

të enjten , më 9 tetor 2003, në orën 10:00
në sallën e Kuvendit të Komunës së Prishtinës

Ftohen të gjithë deputetët e Kuvendit të marrin pjesë.

Propozimi i rendit të ditës është i bashkangjitur.

Следећа седница ће бити одржана:

у четвртак, 9 октобар 2003 у 10.00 часова
у сали Скупштине Општине Приштина

Сви посланици се позивају да учествују.

Предлог дневног реда је у прилогу.

The next meeting of the Assembly will take place on:

Thursday, 9 October 2003 at 10.00 am
Municipal Hall of Pristina

All members of the Assembly are invited to attend.

The draft agenda for the meeting is attached



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet postare (2003/19),
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës (2003/20),
4. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për amendamentimin e Rregullores së përkohshme të punës së Kuvendit,
5. Shqyrtimi i propozimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve,
6. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 16 tetor 2003:
 - 6.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për inspektoratin sanitar (2003/24),
 - 6.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit të sportit (2003/27),
 - 6.3 Shqyrtimi i propozimit të panelit lidhur me kundërshtimin e Koalicionit „Kthimi” në Ligjin për qasje në dokumente zyrtare.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Друго разматрање Нацрта закона о поштанским услугама (2003/19),
3. Друго разматрање Нацрта закона о заштити на раду, заштиту здравља запослених и животне средине (2003/20),
4. Разматрање препоруке Законодавне комисије о изменама и допунама Привременог Пословника Скупштине,
5. Разматрање предлога Правосудног и тужилачког веча Косова за именовање судија и тужилаца.
6. Предлог дневног реда за пленарну седницу од 16 октобра 2003:
 - 7.1 Друго разматрање Нацрта закона о санитарној инспекцији (2003/24),
 - 7.2 Прво разматрање Нацрта закона о спорту (2003/27),
 - 7.3 Разматрање предлога панела у вези са приговором Коалиције „Повратак” на Закон о приступу службеним документима.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting,
2. Second reading of the Draft Law for Postal Services (2003/19),
3. Second reading of the Draft Law for Health Insurance and Safety working environment (2003/20),
4. Review of the recommendation of the Legislative Committee for the amendments on the Provisional Rules of Procedure,
5. Review of the proposal coming from the Judicial and Prosecutorial Council of Kosovo for the appointment of judges and prosecutors.
6. Proposal for the agenda of the Plenary Session on 16 October 2003:
 - 7.1 Second reading of the Draft Law on Sanitary Inspectorate (2003/24),
 - 7.2 First reading of the Draft Law on sport (2003/27),
 - 7.3 Review of the proposal for the panel regarding the coalition „Return” in the Law for access to public documents.

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 09 TETOR 2003

SEANCA U MBAJT NË SALLËN E KUVENDIT KOMUNAL -PRISHTINË

Seanca filloi punën në orën 10,00.

SEANCËN E KRYESOI AKADEMIK NEXHAT DACI, KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.

BASHKËKRYESUESE NAFIJE GAŞ, ANËTARE E KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.

KRYETARI I KUVENDIT:

Mirëmëngjes, kolegë të nderuar deputetë, mirëseardhje në Seancën e rregullt plenare, mirëseardhje kryeministrit dhe ministrave, mirëseardhje edhe përfaqësuesve të zyrave diplomatike në Kosovë.

Mendoj se rendin e ditës dhe materialet tjera i kemi marrë me kohë.

Rendi i ditës është i njëjti i vazhdimit të seancës së kaluar.

Pikë e parë e rendit të ditës është – Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Unë ju thash rendi i ditës është i njëjti. Materialet i keni.

(Një deputet flet prej vendi, nuk dëgjohej qartë: “Pikërisht rendin e ditës dëshirojmë me diskutue. Situata nuk është e tillë sikur që mendoni ju. Mos na qitni në pozita të tilla që para elektoratit, dhe si njerëz, të mos jemi në gjendje.....).

KRYETARI I KUVENDIT:

Shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, jo për rëndin e ditës. Rendi i ditës është i aprovuar.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuari kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar kolegë,

Situata në Kosovë është e atillë sa që ne nuk mund të kalojmë aq lehtë në këtë rend dite dhe të procedojmë me një procedurë normale. E dini që ne, ka gati një muaj të plotë, po kërkojmë që ky Parlament të demonstrojë fuqinë e vet kushtetuese. Pra, të marrë vendime për të cilat është edhe përgjegjës. Dhe, e dijmë që në mbledhjen e kaluar, e cila është mbyllur, do të thoja në mënyrë arbitrare, dhe pa u lejuar që Parlamenti ta thotë fjalën e vet, ne kemi nisë një punë të cilën nuk e kemi kryer dhe kërkoj, në emër të Grupit Parlamentar, që të vazhdohet debati për atë çështje dhe të tentohet, të tentohet arritja e një konsensusi institucional, i cili do të legjitimohet nga ky Parlament.

Meqenëse demokracia në Kosovë është në një shkallë shumë më të zhvilluar, meqenëse Kosova tani ka institucionet demokratike - një Parlament demokratik me legjitimitet të plotë të popullit të Kosovës, një Qeveri parlamentare dhe institucionin e presidentit, në emër të PDK kërkoj që të rrespektohen institucionet e Kosovës dhe vendimet politike të merren pikërisht në institucione të Kosovës, aty ku edhe duhet të shprehet vullneti politik i popullit të Kosovës.

Duke u nisur se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm po mbanë shumë takime me përfaqësues të institucioneve të Kosovës, për të cilat ky Kuvend fare s'po informohet zyrtarisht, unë, edhe një herë kërkoj dhe ripërsëris kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK që të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës t'i drejtohen këtij Kuvendi meqenëse janë zgjedhë nga ky Kuvend dhe të thirren e vijnë në këtë Kuvend, fillimisht Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, që duhet t'i drejtohet këtij Kuvendi dhe të prezentojë rolin e tij dhe përgatitjet që ka bërë UNMIK-u për këto kontakte. Pastaj (më vjen mirë që kryeministri ka ardhur dhe në mbledhjen e kaluar ishte), të thirret edhe presidenti i Kosovës që edhe ai të vijë dhe të arrijmë një konsensus institucional në këtë Parlament, në këtë Kuvend.

Unë kërkoj, në emër të Grupit Parlamentar që kjo çështje mos të zbritet në nivel të çështjeve teknike, por ne të marrim përgjegjësitë që kemi dhe kërkoj që sot, po do të thoja ndoshta edhe nesër, edhe pasnesër, deri në datën 13 ky Kuvend të jetë i konvokuar tërë kohën dhe t'i ushtrojë përgjegjësitë që ka. E di që është vështirë arritja e këtij konsensusi, por jam i sigurt se ky konsensus është më i mundshmi të arrihet në këtë Kuvend sesa në takimet e ndara, në takime që, nganjëherë edhe zbritin nivelin e Kosovës, për shkak se Kosova, siç thash, tani ka një demokraci institucionale, tani ka institucionet, të cilat edhe janë të pranuar ndërkombëtarisht dhe të cilat duhet të demonstrojnë e ushtrojnë fuqinë e tyre. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Sipas rregullit të procedurës, në qoftë se një grup parlamentar kërkon diçka pa debat, hudhet në votim.

Vetëm një sqarim. Çdo seancë parlamentare ka përfunduar në mënyrë demokratike në saje të rregullave të procedurës që zbatohen në këtë Parlament. Ai është mendimi individual i secilit, ndërsa mendimin në procesverbale e keni për secillin. Prandaj, edhe pak po pres, në qoftë se kanë grupet parlamentare diçka... Zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Ne kemi marrë një rend dite, por nuk e di që ky rend i ditës, sipas miratimit të Kryesisë, nuk e parasheh një vazhdim të një debati që ka qenë në seancën e kaluar dhe unë them se, derisa partitë qeverisëse apo bashkëqeverisëse nuk kanë arritur konsensusin e duhur, dhe mendoj se është e panevojshme që ne të debatojmë për asgjë kur nuk kemi konsensus ndërpartiak.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk mund të ketë konsensus me asnjërën nga partitë politike; në rast se ne nuk pajtohemi për çështjet më elementare që janë për qytetarin dhe për Kosovën.

Po përsërisim: Nuk ka konsensus pa kompletimin e Qeverisë, pa transferin e kompetencave nga UNMIK-u tek Qeveria e Kosovës; pa kompletimin e Qeverisë me ministrinë e jashtme, të rendit dhe të drejtësisë – si minimum. Nuk ka

konsensus me partitë bashkëqeverisëse pa u deklaruar vullneti i popullit të Kosovës në këtë Kuvend. Nuk ka konsensus për biseda pa kërkuar falje Serbia për gjenocidin dhe krimet që i ka bërë në Kosovë.

Ne i përsërisim këto qëndrime e në rast se dikush mendon që me anë të votave të përcaktojë një konsensus të imponuar, atëherë do të gabojë. Dhe, ne nuk e shohim absolutisht të arsyeshme që kjo çështje të riaktualizohet pa u bërë asnjë hap pozitiv në realizimin apo plotësimin e këtyre kërkesave që janë elementare për qytetarin dhe popullin e Kosovës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Zoti Dugolli, ju falemnderit. Para se të procedojmë, sipas procedurës, unë ndiej obligim t'paraqes një informacion të shkurtër, meqë këtu janë të pranishëm edhe pjesëmarrës tjerë të takimit të mbrëmshme. Nga mediat jeni të informuar për kohëzgjatjen e takimit. Është shtruar edhe mbrëmë e njëjta kërkesë nga përfaqësuesi i PDK që kryetari i Kosovës, kryeministri dhe zoti Hollkeri t'i drejtohen Parlamentit. Nuk është arritur pajtueshmëri për këtë. Ka mbet vetëm një kërkesë e vetmuar për këtë. Unë nuk po e them – është e arsyeshme... Obligimet kushtetuese i di dhe i rrespekton gjithëkush konform koncepteve të veta.

Në qoftë se, si në darsëm, ne mund ta ndërprejmë dhe vazhdojmë. Unë po ju them, do të rrespektohet çdo kërkesë dhe çdo rregull. Po them, nuk është arritur pajtueshmëri. Dhe, po ju them me përgjegjësi, ka qenë një takim shumë serioz dhe shumë përmbajtësor. Përfaqësuesit e kësaj këmbë kanë dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh dhe pozitiv në ndihmesë të kapërcimit të problemeve që janë në rend të ditës. Ka qenë po ashtu një mundim, një tentim i madh edhe i Përfaqësuesit Special në këtë drejtim. Takimi ka qenë me disa pauza, jemi munduar edhe bashkërisht të pranishmit, bashkërisht të gjithë. Sa kemi mundur që t'i afrojmë? Në kërkesat unike të grupit shqiptar, të grupit kosovar në atë mbledhje është arritur një avancim shumë i madh, në krahasim deri me natën e mbrëmshme, i mendimeve të bashkësisë ndërkombëtare ndaj kërkesave reale të drejta që i ka shtruar kryeministri i Kosovës, i cili e ka pasë edhe mbrëmë përkrahjen e plotë të të gjithë të pranishmëve kosovar.

Është vlerësuar që ajo marrëveshje, jo marrëveshje, në një mënyrë ai ofrim i pozicioneve që t'na ofrohet me shkrim dhe ta kemi të shkruar. Kjo është esenca e

asaj çka ka ngjarë mbrëmë dhe mediat e kanë thënë çka ka qenë e mundshme në takimin e mbrëmshëm të arrihet.

Tani, ju lutem, për vëmendjen tuaj. Shefi i Grupit Parlamentar të PDK... Dëgjuat propozimin. Unë jam i obligueshëm, sipas rregullave të procedurës që ta vë në votim, pa debat, atë. Urdhëroni, zoti Thaqi, si lider i Partisë Demokratike të Kosovës.

HASHIM THAQI:

Të nderuar deputetë, të nderuar përfaqësues ndërkombëtar prezent sot në Kuvendin e Kosovës,

Tashmë, të gjithë jeni të informuar për procesin e ndieshëm që jemi duke e kaluar si institucione dhe parti politike në Kosovë për të ardhmen e vendit dhe të popullit të Kosovës. Ju e dini se është oferta shumë serioze e komunitetit ndërkombëtar për vërien e dialogut në mes Prishtinës dhe Beogradit. Institucionet e Kosovës kanë qenë serioze në diskutimet e tyre fillimisht rreth këtij problemi kardinal për të ardhmen e vendit. Por gjithashtu mendoj se zhvillimet që kanë ndodhur në dy ditët e fundit ka natyrisht, që janë krejt normale, opinione të ndryshme të spektrit politik dhe institucional sa i përket këtij problemi.

Unë kam theksuar edhe më herët se koncensusin duhet ta ruajm si sytë e ballit për hirë të interesave të qytetarëve të Kosovës. Por, natyrisht se duhet edhe të diskutohet për çfarë lloji konsensusi. Konsensus për pavarësinë e Kosovës, apo konsensus për procesin që në fakt e largon Kosovën nga rruga për pavarësi.

Është meritë e popullit të Kosovës dhe e njerëzve që kanë dhënë kontributin e jashtëzakonshëm për çlirimin e Kosovës dhe tash e katër vite jemi të ndarë nga Serbia. Prandaj, këtu sot duhet të votohet – ju kush është për propozimin e PDK që u dha nga shefi i Grupit Parlamentar, të cilin natyrisht, e përkrah edhe unë si kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe për sqarim, zoti Daci, çdoherë që shefi i Grupit Parlamentar të PDK flet - flet edhe në emër Partisë, edhe në emër të kryetarit. Por, mendoj, nëse qitet në votim diçka, atëherë duhet të qitet thjesht: a është Kuvendi i Kosovës për vërien e dialogut me Serbinë apo jo. Dhe jo – kush është për propozimin e AAK; kush është për propozimin e Partisë Demokratike të Kosovës, apo të Lidhjes Demokratike, apo të përfaqësuesve të minoritarëve. Unë, edhe mbrëmë, kam kërkuar. Ne kemi zgjedhur bartësit e institucioneve me një marrëveshje, të cilën e ka votuar Parlamenti. Ne nuk duhet ta injorojmë

Parlamentin. Nuk duhet t'i mbyllim debatet në Parlament. Parlamenti është për të folur, për të diskutuar. Jo për të tejkaluar gjërat shkel – e shko! Prandaj, kam kërkuar që në Parlamentin e Kosovës të vjen, të jetë prezent, edhe kryetari i Kosovës, që është edhe kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryeministri i Kosovës, natyrisht zoti Daci është këtu, dhe t'i drejtohen deputetëve në mënyrë që të sqarohen deputetët për çka po shkon delegacioni i Kosovës në Vienë, cila është platforma e delegacionit të Kosovës për takime me Serbinë. Cilat janë prioritetet, cilat janë favorët dhe natyrisht Kuvendi, jam i sigurt, se do të marrë një qëndrim shumë të qartë, shumë serioz dhe në përputhshmëri të plotë me interesat e qytetarëve të vendit.

Prandaj, do të ishte shumë me rëndësi, zoti Daci, që të qitet në votim apo të kërkohet urgjentisht që edhe kryetari i Kosovës t'i kryejë obligimet e veta në përputhshmëri me Kornizën kushtetuese, t'i drejtohet deputetëve. Askund në botë nuk ndodh që një ngjarje e tillë – historike, ngjarje historike ka edhe për të mirë edhe për të keq, të zhvillohet pa kaluar përmes Parlamentit.

Njerëzit janë zgjedhur prej popullit dhe natyrisht kanë obligime edhe para elektoratit. Nuk është mirë askush që të fitojë vota në emër të pavarësisë dhe, natyrisht, të punojë ndoshta në proces të kundërt.

Është mirë me ardhë me na tregue thjeshtë, është mirë me ardhë me na tregue këtu – cila është ajo ofertë që Kosova ia ofron takimit në Vienë.

Gjithashtu, është shumë me rëndësi që të sqarohet qartë pozicioni i kosovarëve: cila është platforma. Unë nuk e di platformën, megjithëse mbrëmë kemi qenë në takim dhe nuk është prezentuar platformë nga përfaqësuesit e Kosovës. Të shohim opinionin e Kuvendit. Le të mblidhemi edhe sot pasdite, qoftë nevoja edhe nesër, pasnesër dhe jam i sigurt se Kuvendi do të marrë një vendim shumë të përgjegjshëm. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Zoti Thaqi falemnderit. Një sqarim. Çka do të vëhet në votim dhe në rend të ditës janë organet e Kuvendit, është kryetari i Kuvendit. Dhe, ju, sigurisht, si deputet dhe lider i partisë së dytë, keni drejtë në mendimin tuaj, të cilin e rrespektoj. Por, në qoftë se mendoni se mund të më mësoni ose të më diktoni, mos humbni energji, prej ditës së parë ju kam thënë – atë ditë kur jam zgjedh. Do ta rrespektoj, strikt Rregulloren e punës, vullnetin dhe gjithmonë, në mënyrë

demokratike, do t'i përfundojmë proceset. Është mendim individual i gjithëkujt kah po shkojnë proceset dhe unë ju mirëkuptoj, do të thotë, frika e juaj dhe e numrit të madh të deputetëve ose numrit të vogël. Unë do të thoja, para rezultateve në shkencë ai që flet është antishkencëtar, për politikë nuk po flas. Do të thotë, i presim rezultatet dhe nuk është mirë me dalë me akuza ndaj askujt. Por, ajo është çështje e përceptimit individual dhe le të jetë e individualitetit ose partisë.

Prandaj, ju lutem, sipas Rregullores, një grup parlamentar kërkon atë që e kërkoi shefi i Grupit Parlamentar.

Kush është për propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës le të çojë dorën. Ju lutem t'i numëroni votat.

Ju lutem, me votim - 26 deputetë kanë votuar për këtë propozim. Të pranishëm janë 96 deputetë. Nuk aprovohet propozimi. Nuk aprovohet propozimi! Nuk ka kundër, as abstenime. 50 plus 1 gjithmonë të të pranishmëve merret vendimi pozitiv. Me 26 vota nuk ka vendim, ju lutem. Vazhdojmë me rendin e ditës.

(Prej vendit: Duhet parë edhe abstenimet. Unë abstenoj.)

KRYETARI I KUVENDIT:

Është e drejtë juaja. Unë thash, kisha pyetur për - kush është kundër, po të kishte qenë numër rrespektabil.

Përfundoi, zoti Dugolli. Fjalën e kishit, ju lutem.

(Dugolli, prej vendi: Unë s'jam as kundër, as për... por kjo nuk është e drejtë).

KRYETARI I KUVENDIT:

Mirëde, në rregull, s'jeni për. Unë po ju lus, edhe në Kryesi i kemi shpeshherë këto gjana. Mundohet pakica, me presion. Mundohet pakica me presion me arritë rezultat pozitiv. Kjo nuk pranohet në demokraci. Kjo nuk pranohet. Prandaj,

është e drejtë e juaja me protestu, kur ta keni shumicën e të pranishmëve. Urdhëroni, zoti Dugolli, e ka fjalën edhe një herë.

BUJAR DUGOLLI:

Unë dua ta jap një... Unë po shoh se nuk po shkon procedura demokratike. Megjithatë, duhet të qitet në votim: kush është për, kush është kundër, kush abstenon, apo ka mendim tjetër. Ju lutem, Grupi Parlamentar i Aleancës abstenon në këtë votim dhe ne nuk dëshirojmë t'na rreshtohet "pro atij grupi" apo "pro këtij grupi". Dhe, ju lutem të rrespektohen procedurat demokratike. Ne abstenojmë sepse nuk ka konsensus për këto biseda në Vienë dhe nuk dëshirojmë që ta qesim këtë në votim me shumicë të votave dhe të bëhen thyerje apo ndarje edhe më të mëdha për këtë qëllim. Dhe, qëndrimi i Grupit tonë që abstenojmë për të vazhduar një debat shterrpë pa kurrfarë rezultati, sepse nuk ka konsensus për biseda në Vienë më 14-tin. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Le të shënohet në procesverbal, deputetët e Aleancës abstenojnë. Zoti Arsim Bajrami, për të dytën herë.

ARSIM BAJRAMI:

Unë shpresoj se ky Kuvend nuk do ta konceptojë gabimisht demokracinë. Demokracia nuk është vetëm votim dhe mbivotim. Demokracia nënkupton edhe arsyen, e arsyeja kërkon që ne të jemi shumë të përgjegjshëm dhe ky Kuvend të merret me atë që duhet të merret. Jo për t'i ikur nga.... Padrejtësisht, që një muaj ditë po i ikim këtij problemi. Padrejtësisht po e zbrisim nivelin institucional në Kosovë duke ikur prej problemeve. Unë kërkova diçka krejt të arsyeshme dhe mendoj se Kuvendi s'ka asnjë arsye logjike për ta refuzuar atë që kërkova. Kërkova që ky Kuvend të jetë i konvokuar tërë kohën, tërë kohën, siç bëjnë kuvendet serioze në shtetet demokratike dhe ky t'provojë ta arrijë konsensusin.

Po përsëris. Jam mëse i bindur se konsensusi është më i mundshëm në këtë Kuvend, jo duke thirrur liderët, jo duke u ulur në darka, jo duke bërë takime jotransparente. Askush, nga 120 deputetë, sa jemi në Kuvend, nuk është i

informuar se ç'është biseduar dje. Nuk është korrekte, meqenëse ky Kuvend është organ më i lartë i vetëqeverisjes me Kornizë kushtetuese.

Propozimi i PDK nuk ishte presion, siç tha kryetari, por ishte një propozim krejt logjik, krejt i arsyeshëm, i cili dëshiron të krijojë një imazh autoritativ çfarë i duhet Kosovës. Në qoftë se veten nuk e faktorizojmë ne, në qoftë se këtë Kuvend nuk e bëjmë faktor të zhvillimeve dhe proceseve politike, mos të presim të tjerët të na faktorizojnë. Kështu që, po më duket, gabimisht po interpretohen propozimet krejt normale, krejt të arsyeshme, të cilat ky Kuvend po i hudhë me aq, me aq lehtësi.

KRYETARI I KUVENDIT:

Zoti Bajrami, ose përqëndrohuni kur doni me i dëgjuar fjalët, ose mos i citoni gabimisht... Unë nuk thatë se ju bëtë, thash ka presione edhe në Kryesi, edhe atë – minoriteti, gjithmonë. Unë ju falënderoj që dolët me më ndërgjegjësu, por demokracia e njeh vetëm një parim – parimin e votës së lirë. Dhe, i dëgjon të gjitha mendimet e kundërta. Unë ju thash, dy herë e kërkuat fjalën dhe është në rregull. Në qoftë se nuk e keni përkrahjen në vendimmarrje, duhet të pajtoheni dhe me punën e secilit të veten, në elektorat e merr fuqinë dhe fuqinë e vendosjes.

Urdhëroni, Hydajet Hyseni, si anëtar i Kryesisë.

HYDAJET HYSENI:

Ju falemnderit. Të nderuar deputetë,

Ju përkujtoj se debati, për të cilin po flasim, është hapur me kërkesë të Qeverisë, me kërkesë të qartë që Kuvendi të marrë qëndrime. Qëndrime, ky Kuvend, nuk ka marrë. Çështja prandaj mbetet e hapur. Ju përkujtoj, sërish, se ky Kuvend, muaj më parë, në një situatë pothuaj të ngjashme, është angazhuar që të harmonizojë qëndrimet dhe të dalë me qëndrime konsensuale para Kuvendit dhe para opinionit kosovar. Prandaj, mendoj se edhe nga ky aspekt jemi të obliguar të vazhdojmë përpjekjet për të ndërtuar qëndrimet. Kurse, nga ana tjetër, megjithatë Kuvendi duhet të punojë me rregulla, zoti kryetar. Dhe, Rregulla 27 për votimin, ju përkujtoj, e sqaron shumë qartë dhe pa ekuivoqe se si merren vendimet në Kuvend. Po citoj: "Votimi bëhet përmes njërës prej mënyrave në vijim – votimi i

thjeshtë, “për”, “kundër”, “abstenim” - me ngritje dore”. Prandaj, ju jeni i obliguar, më vjen keq që ju mund ta interpretoni si ders e ndërgjegjësime të tjera, por ne jemi të gjithë të obliguar që të rrespektojmë procedurat. Unë nuk do të dëshiroja që ne të ndahemi, por unë kam bindjen se po të rrespektojmë vullnetin e deputetëve, ne nuk do të ndahemi. Përkundrazi, siç ka qenë edhe në debatet e mëparshme, siç është edhe në shpirtin e shumicës së deputetëve, ne do të kemi qëndrime unike. Prandaj, kërkoj që të rrespektohen procedurat dhe të ndërtojmë qëndrime të përbashkëta dhe bashkërisht. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Zoti Hyseni, mbani ndërsjetull sa të doni Rregulloren... po të votojmë edhe dhjetëfish, po të abstenojnë edhe të gjithë të tjerët, po të jenë të gjithë kundër, njëzetegjashtë vota sot nuk janë vendim pro që obligojnë askend. Ju lutem. Kjo çështje ka përfunduar për sot. Në qoftë se kërkon nevoja, ne do të jemi në mbledhje në seancë plenare çdo ditë dhe çdo natë. Qëndrimet janë të qarta. Mbrëmë janë qartësuar... dhe të gjithë pjesëmarrësit i kanë sqaruar. Është shtruar kërkesa të jetë kryetari i Kosovës, të jetë kryeministri, kryeministri është këtu dhe ka qenë edhe një propozim, zoti Hollkeri ... Nuk është aprovuar ai mendim, as mbrëmë, nuk është aprovuar as sot. Kjo pikë është përmbyllur. Tani japim pauzë prej 15 minutash.

(Vazhdon pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT:

Kuorum kemi, mund të vazhdojmë me punën, ju lutem.

Në rend dite është – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime postare.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për shërbimet postare ka bazueshmërinë në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për shërbimet postare dhe amendamentet e propozuara, nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për shërbimet postare, nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe financiare.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike, reflektojnë qëndrimet e komisioneve parlamentare.

Amendamenti 1, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Ju lutem, për vëmendje dhe përqëndrim në punë.

Amendamenti 2, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni funksional, pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

(Prej vendit: Haki Shatri – E përkrahim, edhe ne.).

E përkrahin. Falemnderit shumë.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 7, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Dy vota kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni funksional, pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

A ka ndonjë sqarim.

(Prej vendit: - Përkrahet, përkrahet.).

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 9, Komisioni funksional, pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

A ka ndonjë sqarim.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 10, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 11, Komisioni funksional, pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

(Prej vendit: Nuk e përkrahim).

Nuk përkrahet. Kush është për Komisionin funksional? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Pesë kundër.

A ka abstenime? Një abstenim.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? Nuk ka abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush.

Amendamenti 14, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush?

Amendamenti 15, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një kundër.

A abstenon ndokush? Nuk abstenon.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 16, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 17, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 18, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 19, Komisioni funksional, pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

Nuk ka sqarime!?

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Dy vota kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 20, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Jo.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 21, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër?

Nojkiq, është procedura e votimit, jo e debatit. Në qoftë se mendoni që keni diçka të shtoni, urdhëroni...

RANDJEL NOJKIĆ:

Gospodine predsjedavajući, dame i gospodo,

Ja želim prvo da se izvinim članovima Komisije za transport i komunikacije, jer sam bio zadužen da podnesem izveštaj Komisije i bio sam na čelu te Komisije. Iz tehničkih razloga nisam to mogao, jer smo imali sastanak u vreme pauze, vi ste ranije počeli i tako, da se ja zaista izvinjavam Komisiji zaštonisam obavio tu svoju dužnost. No, međutim, ja imam još jedan, jednu primedbu «Koalicija» povratak je pored amandmana koji su išli u proceduri i Koalicija «Povratak» je dala svoje amandmane, koje su nam dostavljeni ali vidim da nisu, da se o njima ne glasa. Zbog toga sam izašao kod ovog zadnjeg amandmana, pre nego što se bude glasalo o zakon u celosti. Naime da smo ozbiljno radili ovaj posao i Komisija, i Koalicija «Povratak» govori činjenica da osam amandmana su identična... Znači i Koalicija «Povratak» i Komisija je dala identične amandmane, što znači da se radilo vrlo ozbiljno. S druge strane, postavljeni su, dati su od strane Koalicije «Povratak» određeni amandmani koji zapravo su suštinski i oni su u interesu zaštita prava i interesa zajednica. Možda u nekom normalnom vremenu i u nekim korektnim odnosima ti amandmani ne bi bili važni. No, međutim, na način i tok rasprave za vreme dok je radila Komisija zajedno sa

ekspertima i članovima Ministarstva su zaista izazvali jednu reakciju i zaista smo..., smatramo da su ovi amandmani neophodni.

Naime, evo o čemu se radi. Radi se pre svega o tome, oko javnih operatera, oko licenciranja i oko rezervisanih usluga. Kažem, ponavljam još jedanput, da nije bilo određenih reakcija koje su bile vrlo negativne, možda amandmani ne bi ni bili potrebni. Ali su ovi amandmani u ovom slučaju potrebni iz evo iz kog razloga. Ja sam naime pitao ljude koji su bili u Komisiji šta će se desiti onog trenutka kada bude zakon izglasan i kada se bude postavilo pitanje javnih operatera odnosno interesa korisnika određenih u sluga. Normalno, mislio sam pre svega na PTT koji pruža određene usluge i zasigurno, s obzirom da se bavim profesionalno tim poslom, znam da su te usluge daleko zastupljenije u ovom delu pružanja usluga PTT-ea nego PTK-a. Dobio sam vrlo decidan odgovor – prekinuće sa radom PTT i prekinuće sa pružanjem tih usluga. To je vrlo, ovako, ovaj, jedna izjava koja nije smela da ide i mislim da je zaista jedna takva, jedan ovakav zakon, ukoliko bude usvojen i ukoliko se ne omogući drugim operaterima... ukoliko se ne usvoji da budu dva javna operatera a postoje takva iskustva, znači nema tu ništa, nije tu ništa što je izmišljeno, znači postoje takva iskustva, iako se onemogući rad ovaj funkcionisanje ovog drugog operatera ili pružioća usluga, onda zaista Koalicija «Povratak» će glasati protiv ovog zakona i ja..., i ne samo to, nego ćemo pokrenuti drugu proceduru da se zakon ne proglasi kod SPGS-a time što ćemo dostaviti i blagovremeno svoj prigovor da se otvori panel i da se o tome diskutuje, jer je ovo pitanje vrlo-vrlo važno, 120 hiljada korisnika ili potencijalnih korisnika određenih usluga biće uskraćeni tih usluga i mislim da je to poražavajuće da se donose jedan takav zakon u ovom Parlamentu. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Zoti Nojkiq, disa herë ju kam thënë: unë nuk jam “predsedavajuqi”. Unë jam predsednik! Kjo për relaksim paksa. E dyta, përgjegja është e këtillë, ju lutem. Unë e kuptoj shqetësimin, e kuptoj shqetësimin, dhe si deputetë keni të drejtë, por amendamentet e Koalicionit “Kthimi” në tekstin e këtij Projekligji, janë parashtruar me vonesë. Pra jashtë afatit të përcaktuar në Rregullën 28.1 të Rregullores së punës. Prandaj, është kjo këtu. Megjithatë, është e drejta e deputetëve që në komisione t’i votojnë ose mos t’i votojnë dhe po vazhdojmë me procedurën. Prandaj, replikë nëse keni me mua, veç të drejtën e fjalës. Me mua replikë, a. Po unë jam kryetar, ti s’mund me replikue që s’më pranon ti.

Në emër të komisionit, urdhëro. Cilit komision? Urdhëroni.

QAZIM KABASHI:

I nderuari kryetar, të nderuar ministra, kolegë të nderuar,

Është e vërtetë që kryetari i grupit punues është zoti Nojkiq në punimin e këtij ligji, por aty jemi marrë vesh që ai ta përmbajë qëndrimin e Komisionit, kurse ta ruajë drejtën e mendimit të vet për gjëra që s'pajtohet. Qëndrimi i Komisionit është që operator publik në Kosovë të jetë vetëm një. Dhe, meqenëse dola këtu, ne si Komision dhe, si deputetë me siguri të gjithë, jemi kundër paralelizmave në Kosovë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Nojkiq, replikë.

RANDJEL NOJKIĆ:

Pa ja bih želeo prvo da pitam – po kom poslovniku uradimo, po starom ili po novom? To je nešto što je veoma značajno. Koliko ja znam, novi Poslovnik nije proglašen od SPGS-a i on je nevalidan. Ali, dobro, svejedno.... Ali, ima jedna stvar koja je veoma bitna, suštinski je bitna. Zašto poslanici Koalicije «Povratak» nisu dostavili svoje amandmane ranije? Evo zbog čega: Zato što iskustvo u ovoj Skupštini govori da, kada se postave jedanput amandmani, može nacrt zakona da bude odlučan, razumete, ali da se amandmanima on bitno promeni. Mi smo čekali da vidimo, zapravo kakavi će da budu amandmani, da li će amandmani bitnije da promene nacrt i da bi mogli da uložimo amandmane i na te amandmane. Molim vas, možda je to smešno, ali ja vas molim, saslušajte me. Mislim da bi trebalo da me saslušate. Šta se dešava? Dešava se da, razumete, posle drugog razmatranja zakona sa amandmanima se bitno promeni zakon, i mi više nemamo nikakvu mogućnost da to promenimo. Upravo zbog toga smo čekali i ako ste videli, u petak je zasedala Komisija, mi smo odmah, u ponedeljak dostavili amandmane. Prema tome, nismo čekali ne znam šta, nego smo čekali da vidimo kakvi će biti amandmani, da bi na osnovu tih amandmana dali svoje amandmane. Mislim da je to suština...

KRYETARI I KUVENDIT:

Falemnderit shum. Keni pritë shum, e keni shkelë procedurën prandaj ju lutem të vazhdojmë.

Amendamenti 21... Urdhëro, në emër të komisionit...

GANI PREKOPUCA:

Nuk pata ndërmend të dal, zoti kryetar por më nxiti parafolësi. Unë po i pranoj ato që i tha Nojkiqi, por a bën Nojkiqi me na tregu këtu, pse nuk i pranon ligjet e Kosovës, rregullat e UNMIK-ut, i cili është sot e asaj dite në posten e Fushë-Kosovës udhëheqës e flet këtu, e ka okupue postën e Fushë-Kosovës, e këtu flet për amendamentet që janë vonue.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Po, me procedurë ke të drejtë, ia ka përmendur emrin.

RANDJEL NOJKIĆ:

Vi imate pravo da postavite pitanje, normalno da vam ja odgovorim. Meni je veoma dobro poznata uredba koju je potpisao gospodin Kushner o funkcionisanju PTK-a ali molim vas, ja sam to objašnjavao mnogo puta. Evo i vama hoću da objasnim. Tamo se jednim članom, decidno kaže: da se objekti pružaju, daju na korišćenju PTK-a radi pružanja usluga. S obzirom da mi imamo primere da recimo u srpskim sredinama, u čistosrpskim sredinama PTK-a drži objekte, ali ne pruža nijednu uslugu tom stanovništvu. Ne pruža nijednu uslugu. To jasno govori da smo mi morali da se organizujemo da bi pružili one najpotrebnije usluge. I zbog toga to funkcioniše i to će funkcionisati kolikogod vi budete želeli razumete ili ne budete želeli. Moraće da funkcioniše zato što su to potrebe gradjana i molim vas usluge se pružaju na osnovu potreba gradjana a ne da se ona nameću. Ne možete vi da nametnete usluge.....Hvala vam.

KRYETARI I KUVENDIT:

Replika është një minut, Nojkiq. Boll më, të ka kaluar një minut, të lutem. Ishte ndërhyrja e zotit... Ne po flasim për ligjin jo për tjetërsend dhe për procedura te adaptimit të amendamenteve...

Amendamenti 21, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 22, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 23, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Po s'është, por ju e keni pasë në dorë. Unë po pajtohem.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

Kalon amendamenti.

Dhe tani ta votojmë ligjin në tërësi.

Kush është për ligjin e amendamentuar, ju lutem. Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Numëroni votat kundër. 12 vota janë kundër.

A abstenon ndokush? Nuk ka abstenime.

Prandaj, konsideroj se Ligji është aprovuar në Parlament. Ju falemnderit.

(Duartrokitje)

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For Shumica – Vecina – Majority
 - Kundër – Protiv – Against.....12
 - Abstenime – Uzdržanih – Abstained....00
-

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambient të punës.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambient të punës, ka bazueshmërinë në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambient të punës dhe amendamentet e propozuara, nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambient të punës, nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe financiare.

Amendamentet e propozuara në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimet e komisioneve parlamentare dhe Koalicionit “Kthimi”.

Udhëroni ju deshët... për çka deshët fjalën. Liljana Keniq, apo si quheni? Udhëro, si kryetare e Komisionit.

STOJANKA PETKOVIĆ:

Komisija za rad i socijalno staranje je dobro razmotrila ovaj zakon. Takodje amandmane od Komisije za zdravstvo i od Komisije za zaštitu ambijenta i mi smo dali, takodje kao funkcionalna komisija, svoje amandmane.

Zakon nije sporan, ali je mogao biti mnogo bolji i mnogo bogatiji po pitanju zaštite radnika na svojim radnim mestima ali još jednom naglašavam, u ime Komisije, da imamo primedbe po pitanju lektorisanja zakona. Naime ja bih zamolila sve poslanike da u buduće, kada se budete izjašnjavali za donošenje zakona u načelu da dobro pogledate sve tri verzije zakona i da tada donesete odluku da li ćemo u načelu da prihvatimo zakon ili nećemo, kako ne bi smo kasnije došli u sukob sami sa sobom da se bavimo lektorisanjem zakona, što nije naš posao, svakako i tada već ne možemo da ga vratimo na doradu.

Predlog Komisije je takodje, da u buduće, ako postoji mogućnost, zakon radi na sva tri jezika u jednoj tabeli kako bi svi poslanici uporedo mogli da prate, znači na sva tri jezika zakon. Eto, hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit.

Amendamenti 1, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon kush? Katër abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Të numërohen votat. Gjashtë vota janë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Amendamenti kalon.

Amendamenti 4, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër?

A abstenon ndokush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni funksional dhe Komisioni për shëndetësi, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 7, Koalicioni “Kthimi”, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni i buxhetit.

Kush është për? Le të numërohen votat, ju lutem. 13 për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Koalicioni “Kthimi”, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni i buxhetit.

Kush është për? Numëroni votat, ju lutem. 14 vota për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 9, Koalicioni “Kthimi”, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni i buxhetit.

Kush është për? Numëroni votat. 14 vota për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 10, Komisioni për shëndetësi, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 11, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Dy vota kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Nuk ka abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon kush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 14, Komisioni për shëndetësi, pa përkrahje nga Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit.

A ka kush sqarime, apo të votojmë?

Kush është për Komisionin për shëndetësi? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Tre kundër?

A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 15, Komisioni për shëndetësi, pa përkrahje nga Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit.

Kush është për Komisionin për shëndetësi? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një votë kundër.

A ka abstenime? Dy abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 16, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime a ka? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 17, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 18, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Nuk ka abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 19, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon kush? Nuk abstenon askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 20, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Nuk abstenon.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 21, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Nuk abstenon.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 22, Komisioni funksional, i përkrahur nga ato kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 23, Komisioni funksional, i përkrahur nga ato kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 24, Komisioni për shëndetësi, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 25, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 26, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 27, Komisioni për shëndetësi, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 28, Komisioni funksional, i përkrahur nga ato kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 29, Komisioni për mjedis dhe planifikim hapësiror, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Nuk abstenon.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 30, dy propozime...

Le të sqarohen.

ILAZ PIREVA:

Kështu, duken në shikim të parë se janë njësoj, megjithatë ka një ndryshim sepse në amendamentin e Komisionit funksional jipet sikur është këtu, por thotë “vazhdon teksti si në Projektligj”. Do të thotë mbetet teksti si në Projektligj pastaj, pas kësaj fjalie. Këtu ndryshon ajo në mes Komisionit shëndetësor dhe Komisionit funksional. “Punon me substanca të rrezikshme dhe në kushte shumë të ndyera”, është ai teksti që duhet të vazhdojë. Në vend “pune” do të thotë “me substanca të rrezikshme dhe në kushte shumë të vështira”, ndërsa i Shëndetësisë e ka heqë edhe atë. Prandaj, këtu duhet të miratohet amendamenti i Komisionit funksional. Kështu edhe jemi marrë vesh me Komisionin e shëndetësisë.

KRYETARI I KUVENDIT:

Kush është për FunkSIONALIN? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Një abstenim.

Kalon varianti a) i amendamentit.

Amendamenti 31, Komisioni për shëndetësi, i përkrahur nga komisionet tjera.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 32, Komisioni për mjedis dhe planifikim hapësiror, i përkrahur nga komisionet tjera.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Dy vota kundër.

A absteno kush?

Kalon amendamenti.

Ta kryejmë këtë. Është e pamundshme, dyfish më shumë amendamente se nene!? Bile është një amendament këtu, thotë: “në gjuhën shqipe fshihet fjala “ligj” – amendament”! Po në jemi marrë vesh që komisioni përkatës, në Parlament, ta unifikojë tekstin dhe ta sjellë...

Amendamenti 32, Komisioni për mjedis dhe planifikim hapësiror, i përkrahur nga komisionet tjera.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Nuk abstenon.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 33, Komisioni për mjedis, i përkrahur nga komisionet tjera.
Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 34, Komisioni për mjedis, i përkrahur nga komisionet tjera.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 35, Komisioni për shëndetësi, pa përkrahje nga Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit.

Kush është për?

Kryetare e Komisionit, urdhëro, më fal.

STOJANKA PETKOVIĆ:

Çlanovi Komisioni su tražili da dam obrazloženje po pitanju amandmana 35 i amandmana 36. Dakle amandman 35. od Komisioni za zdravstvo apsolutno nije u nekoj suprotnosti sa amandmanom 36. Razlikuju se samo u jednoj reči odnosno Funkcionalna komisija je dodala reč “svetlost”...

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 36, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? ...

Për cilin amendament po doni...

(Prej vendi: Paj për amendamentin 35. Nuk është normal të dyja, zoti kryetar me i votue).

Njëri, 35-shi u votua. Tash jemi në 36-tin, Nafije. Po pse i keni bërë, moj zonj.

NAFIJE BERISHA:

Dëgjoni! Në amendamentin 35 – Komisioni për shëndetësi, propozohet që nenit, që ka të bëjë lidhur me “zhurmën dhe dritën” t’i shtohet vetëm titulli “drita”, kurse Komisioni funksional propozon që lidhur me “dritën” të shtohet një nen i ri, të mos quhet “drita” por “ndriçimi” sepse përfshin më shumë... Thotë, “në çdo

vend pune duhet të sigurohet ndriçim i mjaftueshëm natyral ose artificial dhe mbrojtja nga ndriçimi i tepërt”. Këtu s’kishte pasë kuptim dyjat me u aprovua. Ma merr mendja se kjo e Komisionit funksional është më e arsyeshme.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit.

Kush është kundër amendamentit 36? Nuk ka votë kundër.

A abstenon kush? Nuk abstenon.

Qysh t’i shkruani, pastaj kështu edhe duhet, le të merreni... Ju falemnderit.

Amendamenti 37, Komisioni për shëndetësi, i përkrahur nga komisionet tjera.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 38, dy propozime: ...

STOJANKA PETKOVIĆ:

Funkcionalna komisija, dakle dala amandman da «sledi novčana kazna», umesto «do 35 hiljada» bude «50 hiljada evra». Članovi naše Komisije su tražili obrazloženje od Komisije za budžet – zbog čega nije prihvatila ovaj amandman kada znamo o da nisu u suprotnosti, odnosno nemaju implikacije sa budžetom. Pa, ako bi mogao Haki Šatri da nam to objasni.

KRYETARI I KUVENDIT:

A dëshironi. Jo, jo, vetëm nëse doni. Çfarë është propozimi? Të shkojmë sipas amendamentit.

Ju lutem, ne duhet ta ndjekim procedurën. Ju në komisione, përfundimisht arrini pastaj t'i shqyrtoni çështjet. Këtu kemi dy versione: versioni a) dhe b). Mua, më mbetet me thënë:

Kush është për versionin a), i lutem le të çojë dorën.

Kush është kundër, ju lutem? Doni koment, në emër të kujt? Jo, vetëm në emër të Komisionit. Procedura s'të lejon...

Dragisha dëshiron... Unë po ju kuptoj, të gjithë jemi të lodhur. Ta përfundojmë se janë edhe dy-tre nene dhe të bëjmë një pauzë.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Poštovane kolegice i kolege, poštovani predsedniče,

Ovde je reč, opet, o jednoj odredbi koja, po pravilu, ne bi mogla da bude ugradjena u ovaj zakon i mislim da će ova Skupština, ukoliko se izjasni za bilo koji amandman ili ova odredba ostane, napraviti grešku na taj način što će, dakle, u zakon o zaštiti na radu i radnoj sredini biti odredaba koje se regulišu krivičnim zakonom i one nikako ne mogu biti sadržane u zakonima ove vrste. S druge strane, ovde nema nikakvih pitanja za gospodina Šatrija - ima li kakvih implikacija po budžet ili nema. Jer to pitanje i ne treba da se postavlja, s obzirom da ima implikacija po Ustavni okvir, i po rezervisana prava za Specijalnog predstavnika Generalnog sekretara. Dakle, ovakva odredba, u ovaj zakon, ne može da ide. Može da ide u krivični zakon i ja verujem da je ima negde u krivičnom zakonu, u nekom opštijem ili nekom drugačijem obliku, ali ovde ne možete besmisleno raspravljati o amandmanima na ovu odredbu. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë mendoj që mos ta aprovojmë asnjërin version, por të mbetet ligji, sepse nuk e mori shumicën as propozimi a) as b), prandaj mbetet ajo si është në...

(Nga vendi, S. Hamiti: Zoti kryetar, problemi është vetëm te lartësia e gjobës. Domethënë mbetet 35 mijë...).

Po, po, mbetet në ligj sa ka qenë. Unë thash, mbetet ajo në ligj.

(Prej vendit, dëgjohet, N.Berisha: Nuk është në rregull!)

Amendamenti 39, Komisioni për shëndetësi, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 40, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Dhe, i fundit – amendamenti 41, Komisioni funksional, i përkrahur nga ato kryesore.

Kush është për? ... Po, urdhëroni.

FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti kryetar. Komenti ka të bëjë edhe me të ardhmen, besoj, në mënyrën e hartimit të amendamenteve. Ishte diçka e ngjashme edhe në një amendament më herët në Ligjin që e miratuam. Ta zëmë: “Të bëhet harmonizimi i teksteve shqip – serbisht me tekstin anglisht të nenit 4, titulli i nenit 5, nenit 6, 12 dhe 16, si dhe të lektorohet, versioni shqip: pika 2.7 e nenit 2”. Mendoj se kjo pjesë e lekturës, e harmonizimit, e unifikimit të tekstit, nuk është pjesë e amendamenteve. Keni kujdes dhe mos lëshoni. Është pjesë, është detyrim i një komisioni, siç tha edhe kryetari më herët, që do të ketë parasysh këtë dhe nuk mund të shkojë si normë. Amendamenti është krejt diçka tjetër. Kjo është diçka tjetër. Ju falemnderit. Sepse krejt teksti duhet të lektorohet. Nuk është teksti vetëm te neni 2.7.

KRYETARI I KUVENDIT:

Unë mendoj që sqarimi është plotësisht profesional. Prandaj, nuk e votojmë sepse nuk është amendament...

Ju lutem, kush është për ligjin në tërësi, me amendamentet e aprovuara? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Të numërohen votat, ju lutem. 12 vota kundër.

A ka abstenime? Një abstenim.

Konstatohet se Ligji është i aprovuar, me amendamentet e propozuara.

(Duartrokitje)

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Vecina – Majority
 - Kundër – Protiv – Against12
 - Abstenime – Uzdržanih – Abstained.....01
-

Ju lutem. Tani të marrim një vendim. I kemi edhe dy pika. Jemi të gjithë të lodhur. Megjithatë, unë dëshiroj mendimin tuaj. A të vazhdojmë apo të bëjmë pauzë.

Kush është që të vazhdojmë punën? Shumica. Vazhdojmë pra. Unë isha për ta ndërprerë, por demokraci është kjo...

Ju lutemi, të përqëndrohemi dhe ta përfundojmë.

- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese për amendamentimin e Rregullorës së përkohshme të punës së Kuvendit.

Unë besoj se fjalën duhet ta ketë kryetari i Komisionit, profesor Arsim Bajrami. Urdhëroni, Arsim.

ARSIM BAJRAMI:

Të nderuar deputetë,

E dini se, ka kohë që në këtë Parlament është kërkuar sqarim që me cilën rregullore ne punojmë. Mendoj, një çështje që është shtruar disa herë, por asnjëherë s'ka marrë përgjegje.

Në fakt, ne kemi miratuar Rregulloren e Kuvendit të Kosovës qysh vitin e kaluar dhe mendoj se padrejtësisht është zvarritur procedura për hyrjen e saj në fuqi. Ndërkohë, Zyra ligjore e UNMIK-ut ka bërë disa vërejtje, për cilat ka konstatuar se janë tejkalim i kompetencave të Kuvendit dhe bijnë në kolizion me Kornizën kushtetuese.

Komisioni për çështje legjislative, i ka marrë këto vërejtje, i ka shqyrtuar, i ka diskutuar dhe ka menduar se disa nga to duhet të pranohen, për shkak se derisa nuk bëjmë ndërrime adekuate në Kornizën kushtetuese është e pamundshme që me rregullore të bëjmë tejkalime.

Gjithashtu, po e shihni, është shpërndarë një material i Koalicioinit "Kthimi"... Pra, po vazhdohet me një praktikë të paraqitjes së amendamenteve në amendamente, që nuk është një praktikë e mirë dhe Komisioni mendon se të

gjitha këto janë të paobjekt, për shkak se këto shqetësime janë shprehur edhe në punën e Komisionit ku kanë qenë të dy përfaqësuesit e Koalicionit "Kthimi" dhe ata kanë shprehë opinionet e veta dhe disa nga opinionet e tyre janë pranuar, kështu që mendoj se janë të paobjekt. Sidomos, nuk mund të hapet çështja e Rregullores tani, për shkak se Rregullorja është votuar. Është fjala vetëm për shqetësimet që ka bërë UNMIK-u.

Propozimet që kemi dhënë ne, mendojmë se nuk janë të natyrës esenciale dhe është fjala për disa n dryshime terminologjike dhe disa n dryshime që implikon domosdoshmëri Korniza kushtetuese. Derisa kjo kornizë nuk ndërrohet është e pamundur që me rregullore të bëhen zgjidhje tjera.

Ajo që ne kërkojmë, është mesa vijon:

- Kërkojmë që kjo Rregullore, në mënyrë të pashtyeshme, me këto sygjerime, të hyjnë në fuqi. Dhe, të mos harrojmë, rregullorja nuk është një ligj dhe nuk kalon në fazat e procesit ligjdhënës. Nuk kalon në tri lexime. Është një akt autonom i Kuvendit të Kosovës dhe kërkojmë që, në qoftë se Kuvendi sot miraton këtë raport-rregullore, atëherë konsierohet e hyrë në fuqi qysh sot.
- Kërkojmë nga Kryesia e Kuvendit që, pashtyeshëm, ta botojë Rregulloren. Ta botojë Rregulloren dhe të furnizojë të gjithë deputetët me Rregulloren e re të Kuvendit, me Rregulloren e miratuar nga ky Kuvend.
- Kërkojmë, po ashtu, që të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, të pajisen me kartela të reja të identifikimit të deputetit, dhe, së fundi:
- Kërkojmë që të gjithë deputetët të pajisen me libreza të imunitetit. Pra, me atë imunitet, me imunitet të kufizuar që e njeh Korniza kushtetuese, që e njeh Rregullorja.

Kërkoj nga Kryesia, e sidomos nga Shërbimi administrativ i Kuvendit, që pashtyeshëm ta marrë këtë çështje serioze, meqenëse ne jemi në gjysmë të mandatit dhe akoma s'kemi as librezë deputeti as librezë për imunitetin. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Hydajet a e kërkuaat fjalën? Si anëtar i Kryesisë, urdhëroni Hydajet.

HYDAJET HYSENI:

Të nderuar deputetë,

Më është impresive kjo procedura jonë “turbo”, por nganjëherë ko procedura “turbo” po na shkakton turbulenca, të cilat, pastaj, po na shkaktojnë marramendje që po na zgjasin gjatë, me vite ndonjëherë. Dhe, kjo që na ka ndodhur me Rregulloren, është shembull shumilustrues.

Unë kam disa vërejtje, së pari parimore, që mendoj ky Kuvend duhet t’i ketë parasysh. Ne i referohemi Kornizës kushtetuese, do të thotë një dokumenti që është aprovuar ashtu siç është aprovuar, është imponuar ashtu siç është imponuar, por para se të themelohet ky institucion. Prandaj, edhe është i imponuar, që e thotë edhe shkronja e kornizës – procesi i transferit të kompetencave te institucionet, pasi ato të jenë krijuar. Për më tepër, ka patur edhe deklarime shtesë që e kanë avancuar, së paku, deklarativisht këtë proces. Ne u informuam sot se edhe mbrëmë është premtuar se do të kompletohet, së paku, pjesërisht ekzekutivi i Kosovës. Kurse, merreni me mend, ne përpara kemi propozime që e ngrijnë, e konzervojnë, madje ndonjë aspekt e kthejnë mbrapa këtë proces.

Prandaj, tërheq vërejtjen që ne t’i rishikojmë me vëmendje propozimet, sepse është tjetër nëse diçka i është imponuar këtij Kuvendi dhe është tjetër nëse tash ne edhe një herë e rilegjitimojmë.

Prandaj, unë kërktoj që të rishikojmë propozimin, pikën 8.6 dhe ta riformulojmë, në një mënyrë që është mendoj neutrale. Të reformulohet në përputhje me dispozitat përkatëse kushtetuese. Kjo nuk tango asgjë nga ato që janë thënë, por nuk ia lidhë duart pastaj edhe procesit të transferit të kompetencave. Mendoj që i njëjti formulim duhet të vlejë edhe për amendamentin 5. Arsyetimi im është se, së pari, me Rregullore dhe me rregullat përkatëse, ne nuk bëjmë interpretimin e kompetencave të këtij e atij. Ajo bëhet me dokument kushtetues. Për më tepër, amendamenti 5 flet për transparencën dhe nuk ka asnjë logjikë që në këtë pikë, ku flitet për transparencën, ne tani edhe të përshkruajmë a është siç është thënë këtu pjesë e rezervuar dhe ju mendoni çka do të thotë pjesë e rezervuar. Për më

tepër, nuk është e vërtetë se kjo është pjesë tërësisht e rezervuar. Unë i referohem këtu pikës 5.5 të Kornizës, e cila, institucioneve të Kosovës u përshkruan edhe përgjegjësi në fushën e përgatitjes për raste të emergjencës, siç janë: të zhvillojë dhe zbatojë një strategji për planifikimin e rasteve emergjente dhe shërbimet e mbrojtjes civile. Kurse, atje ku flitet për kompetencat e rezervuara, është thënë edhe shprehimisht: përgjegjësitë për sigurinë civile dhe rastet e emergjencës do të merren gradualisht nga institucionet e vetëqeverisjes.

Prandaj, mendoj që në dy këto nene duhet të evitohet mundësia e interpretimit restriktiv të dispozitave kushtetuese.

Propozimi im, mendoj që e eviton këtë.

Kam edhe një vërejtje në amendamentin 2, Rregulla 10, në të cilin flitet për imunitetin. Propozoj që kjo çështje të formulohet kështu: ky imunitet nuk mbulon veprime të inkriminueshme me ligj, duke përfshirë nxitjen e dhunës midis komuniteteve, racave, feve, gjinive e grupeve tjera shoqërore. Arsyetimi është ky: sepse po ta lejojmë këtë, ne inaugurojmë deliktin verbal. Është diçka që nuk haset askund.

Dy. Me propozimin ekzistues, u hiqet imuniteti, si thuhet – veprimeve që hapur propagojnë dhunën. Por, kuptohet, mundësia sikur lejohet kjo për veprime që mund të bëhen fshehur. Ose, sanksionohet në një mënyrë vetëm dhuna midis komuniteteve. E pse jo edhe midis konfesioneve, pse jo midis gjinive. Prandaj, mendoj që formulimi i tillë ka qenë që në fillim i mangët dhe nuk ka pasë logjikë të na rikthehet.

Dhe, vërejtja ime e fundit, nuk është punë e rregullore që ne ta autorizojmë Përfaqësuesin Special a merr pjesë a s'merr pjesë në seancat. Kjo është e rregulluar me kushtetutë. E jona është, eventualisht, me Rregullore të themi se mund të marrë pjesë, por ne nuk mund ta autorizojmë. Prandaj propozoj që ky të bëhet, si themi.

Është edhe një sërëvërejtjesh, që këtu janë shtuar, të natyrës redaktoriale. Ato nuk janë objekt i vërejtjeve të UNMIK-ut, kurse ky tekst ka të bëjë me vërejtjet e UNMIK-ut. Unë propozoj që kjo pjesë, do të thotë, prej amendamentit 8 deri 11 të përfshihen në pakon e ndryshimeve që duhet të bëhen të natyrës redaktoriale, për të cilat janë bërë vërejtje. Ju siguroj se janë me dhjetëra, për të mos thënë – me qindra vërejtje të domosdoshme që duhet të ndryshohen.

Propozoj që kjo të bëhet nga Kryesia, e cila është e obliguar me kornizë dhe me rregullore që të bëjë ndryshime të kësaj natyre. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Kurrfarë redakture, vetëm lekturë. Komisionet tash do të mbërrijnë te ato... Në emër të Komisionit Liljana.... Shkurt, të lutem.

LILJANA KENIĆ:

Poštovani predsedniče, poštovani poslanici,

Ja, jednostavno, ne mogu da se složim sa stavom gospodina Arsima Bajramija, obzirom... i htela sam da pitam zašto naši amandmani nisu ušli u proceduru jer smo ih blagovremeno podneli 23. 9. ove 2003.godine. Mislím da nije u redu da nam neko uskraćuje pravo na amandmane i na podnošenje amandmana. I mislim da ćemo staviti jednu ozbiljnu primedbu na ovaj rad celog Sekretarijata pa i vas, na kraju krajeva. Što se tiče same Komisije, ... pa dobro. U svakom slučaju ja bih predložila da se ovo odloži jer je ozbiljna nepravilnost i trebalo bi da... Žao mi je, ja vas ne razumem. Možete da sačekate da se vratim na klupu pa da mi odgovorite. Predložim da se ovo odloži za sledeću nedelju i da se naši amandmani nadju pred ostalim poslanicima. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Ju lutem. Jo, nuk e kam n'plan juve kurgjë me ju thënë. Po, urdhëroni Bujar...

BUJAR DUGOLLI:

Dua ta jap një qëndrim të Grupit tonë Parlamentar. Ne kemi votuar Rregulloren, ka muaj përpara dhe Rregullorja nuk bie ndesh as me Kornizën kushtetuese as me punën e Kuvendit të Kosovës. Unë e kuptoj se Komisioni u mundua t'i përgjigjet në njëfarë mënyre ankesave që i ka bërë Zyra ligjore e UNMIK-ut, por mendoj se ne nuk duhet t'i pranojmë as këto propozime të Komisionit, sepse deformatojmë Rregulloren tonë që e kemi miratuar njëherë dhe ne nuk mund të kthehemi prapa.

Domethënë këtë propozim ne nuk do ta mbështesim dhe kërkojmë që të mos mbështetet sepse e dëmtojmë vetë Rregulloren që e kemi nxjerrë disa muaj më herët. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Një sqarim prej shërbimeve e mora. Vërejtjet e Koalicionit "Kthimi" i ka pasë Komisioni dhe të gjitha i ka shqyrtuar. Ato tjerat kanë ardhë me vonesë. Ju lutem tash të procedojmë me rregull.

Komisioni ka kryer punën e vet. Ne vazhdojmë dhe unë mendova një herë që do të shkojmë në tërësi t'i votojmë në pako... Urdhëro Sabri.

SABRI HAMITI:

Grupi ynë Parlamentar i ka shqyrtuar të gjitha këto propozime, që vijnë si vërejtje konkrete të Komisionit. Unë mendoj se Komisioni ka punuar në mënyrë shumë profesionale sepse ka shqyrtuar propozimet që kanë ardhë edhe të një grupi parlamentar edhe ato vërejtje famoze që vijnë nga UNMIK-u rreth kësaj Rregulloreje dhe unë mendoj se ka bërë shumë mirë njëherë e përgjithmonë që i ka shqyrtuar dhe ka dhënë një version.

Unë për vete, por edhe në emër të Grupit Parlamentar, mendoj që këto vërejtje janë të përballueshme dhe nuk ndërrojnë esencialisht kurgjë,- esencialisht po them. Unë i kam studiuar vetë për vete, që me vete e kam Rregulloren dhe jam përpjek t'i shoh të inkorporueme dhe tekstualisht qysh duken këto dhe ku duken dhe m'është duk që diku-diku sqarojnë diçka. Plus kësaj, unë shoh që në këto vërejtje bile janë marrë disa formulime që janë propozuar, formulime edhe nga grupi i "Kthimit" edhe nga aifare komisioni i UNMIK-ut, kush është ai.

Esenciale këtu nuk ka ndryshime. Atje ku zotni Hydajet Hyseni thotë që hyhet në problem të deliktit verbal, nuk është Hydajet, ky thotë: veprime, veprime, - s'është veç me folë. Domethënë, është shumë më thell problemi i këtij formulimi. Unë do të thosha që formulimi është edhe më i fortë se që po mendoni ju. Kështu që, nëse këto nuk do të votohen si të tëra, siç po shihet, që edhe unë atëherë jam që të votohen një për një dhe ta kryejmë punën. S'ka kurrfarë arsyeje, bile është shumëfatlume, shumëmirë që definitivisht ta kryejmë këtë punë dhe mos të flasim

me gjysmë fjale për këtë Rregullore dhe definitivisht të rregullohet sot dhe të dihet cila është në fuqi. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit shumë. Ju lutem për vëmendje.

Kush është për propozimin e Komisionit të autorizuar dhe për të gjitha vërejtjet, amendamentet në tërësi.

Kush është për? Ju falemnderit shumë.

Kush është kundër? Numëroni votat. Pesëmbëdhjetë vota janë kundër.

Kush abstenon? Numëroni abstenimet. Pesë abstenime.

Prandaj, konsideroj se është aprovuar në tërësi propozimi i Komisionit. Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Propozimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve.

Deputetëve me kohë iu është shpërndarë propozimi i Këshillit; rekomandimet e Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese. Arsyetimin e paraqet zoti Arsim Bajrami, në të vërtetë zoti Kolë Berisha, në emër të Komisionit.

KOLË BERISHA:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Komisioni ka shqyrtuar listën e kandidatëve të propozuar nga Këshilli Prokurorial Gjyqësor dhe ka dhënë pëlqimin për të gjithë kandidatët, respektivisht për 23 kandidatë. Nën pikën 2 të këtij raporti, janë katër vetë, për të cilët nuk është dhënë pëlqimi por janë kërkuar shënime plotësuese. Bile një rast e

kemi kur edhe Këshilli Prokurorial ka kërkuar shënimin plotësues dhe këtu na propozon neve si kandidat që duhet të japim pëlqimin. Dhe për tre kandidatët e fundit, Ali Uka, Jelena Krivokapiq dhe Ragip Kadriu nuk ka shënime se ku kanë punuar. Vërtetë nuk dihet se ku kanë konkuruar këta, sidomos për këtë Jelena Krivokapiq dhe Nada Topliçeviq. Kanë konkuruar në republikën e Serbisë, për gjyqësinë kosovare. Ndërkohë kanë lindur reagime nga anëtarët tjerë, nga deputetët tjerë të Kuvendit për disa kandidatë, kështu që ato mund të bisedohen edhe tash, kush i ka vërejtjet e veta. Natyrisht se Komisioni nuk është i përkryer që të mund të dijë për secilin por ka vendosë në bazë të dokumentacionit që ka pasë përpara dhe të dhënave që janë dhënë në vetë mbledhjen e Komisionit. Ka pasë informata prej anëtarëve të Komisionit që kanë njohur disa kandidatë dhe kanë dhënë mendimet e tyre, prandaj ky është rezultati i punës së Komisionit. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit zoti Berisha. Unë nuk po e shoh të arsyeshme... Janë paraqitur dy-tre kandidatë. Nekibja është paraqitur e para.

NEKIBE KELMENDI:

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk do të diskutojë për listën e kandidatëve të propozuar nga Këshilli Gjyqësor Prokurorial për gjykatës, përkatësisht prokurorë, por do ta ngris një çështje e cila mendoj se është mjaft e rëndësishme kur të vendosim për t'i votuar listat si tërësi.

Të gjithë e dimë se institucionet gjyqësore janë të ndërtuara pas përfundimit të luftës, në bazë të Rezolutës 1244 nga ana e UNMIK-it. Këto institucione prandaj punojnë sipas ligjeve për të cilat ka vendosë UNMIK-u dhe rregulloreve të cilat janë nxjerrë nga UNMIK-u.

Këshilli Prokurorial Gjyqësor, kur shpallë konkursin për gjyqtarë dhe prokurorë, shpallë konkursin për gjyqtarë dhe prokurorë të institucioneve gjyqësore të Kosovës që nënkupton se të gjithë kandidatët duhet të aplikojnë për t'u emëruar gjykatës dhe prokurorë në institucionet e Kosovës.

Kemi raste kur kandidatët e caktuar, kur aplikojnë për t'u emëruar gjykatës dhe prokurorë nuk aplikojnë në institucione e Kosovës por aplikojnë në Ministrinë e drejtësisë së Serbisë dhe unë kujtoj se ky gjest apo ky veprim është në kundërshtim me të gjitha ligjet që i ka nxjerrë ky Kuvend, me Rregullore, me Rezolutën 1244, sepse injorohen tërësisht institucionet gjyqësore të Kosovës. Nëse injorohen institucionet, atëherë nuk e dij edhe pse paraqiten njerëzit për të punuar në këto institucione.

Nga ana tjetër, çështja që do të ngris është se: a po emërojmë në gjykatës dhe prokurorë që të punojnë sipas ligjeve në fuqi në Kosovës, me Rregulloren 1999/24 apo po emërojmë gjykatës që paguhen nga buxheti i Kosovës, kurse punojnë sipas ligjeve të Serbisë. Lidhur me këtë çështje, kisha dëshiruar që këtij Parlament i t'i drejtohet dhe të japë sqarim udhëheqësi i Shtyllës së parë, zoti Zhan Kristian Kadi dhe të përgjegjet në pyetjen e deputetëve, apo në pyetjen time – se, me cilat ligje punojnë institucionet gjyqësore në Zubin Potok dhe në Leposaviq.

Njëkohësisht, do të dëshiroja që ta dëgjoj një raport lidhur me atë se çka ka ngjarë në Dubravë, në Burgun e Dubravës, ku kanë humbur jetën gjashtë persona. Ne si deputetë, nuk e dijmë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Ka shumë diskutues. Hajredin Kuqi, urdhëro...Bile, besoj të jenë vërejtje konkrete.

HAJREDIN KUQI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj,

Unë nuk kam dal që të flas për dikë personalisht, por mendimi im është që një kriter duhet të respektohet në Këshillin Prokurorial dhe Gjyqësor. Arsyeja e vetme është që unë kam pa emra aty që kanë mbarë studimet në Serbi, kanë punuar në Serbi deri në 2003 dhe nuk e dij se a e kanë ata të drejtën e regjistrimit civil në Kosovë. Unë e them me kompetencë se të gjitha të drejtat e të huajve, që kanë të bëjnë me një vend tjetër, që unë e konsideroj Serbinë dhe Kosovën, minimumi është që ata të kenë të drejtën e regjistrimit civil. E kundërta e kësaj, e drejta për prokurorë, gjyqtarë dhe funksione tjera publike është e drejtë

absolutisht e rezervuar. Dhe, mendoj në këtë kontekst, nuk ka nevojë që të na vijnë propozime të tilla me njerëz që kanë shtetësi të ndryshme. I vetmi përjashtim mund të jetë ata që i emëron Përfaqësuesi Special, pra ata vijnë me mandat të caktuar, e dijmë se kemi prokurorë dhe gjyqtarë tjerë. Por të tjerët që emërohen si përfaqësues vendor, apo si gjyqtarë apo prokurorë vendor, ata gjithësesi duhet të kenë me një mënyrë edhe shtetësinë e Kosovës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Ramadan Kelmendi, le të bëhet gati Halil Ahmetaj.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,

Duke pasur në konsideratë të lartë punën e Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, unë me këtë rast, lidhur me rekomandimin për emërimin e kandidatëve për gjyqtarë, të paraqitur me datën 30.9.2003, më lejoni të shpreh shqetësimin tim dhe atë lidhur me propozimet nën numër 1, numër 18, 19, 20, 21, 23, sepse kërkoj që të kemi shënime dhe sqarime plotësuese, për shkaqet e poshtshënuara:

1. Kandidatët e propozuar, të cekur nën numrat e më lartpërmendur, prej numrit 18 deri 23 kandidatët e propozuar për gjyqtarë në Mitrovicë dhe Leposaviq, nuk i plotësojnë kriteret e caktuara me pjesën e katërtë të sistemit gjyqësor, pika 9, nën 4 dhe 7 të Kornizës kushtetuese të Kosovës.
2. Me kodin e etikës dhe sjelljes profesionale të gjyqtarëve, nuk e plotësojnë asnjë kriter dhe,
3. Të na sqarohet se gjyqtarët e propozuar në Mitrovicë dhe Leposaviq a janë inkorporuar në sistemin gjyqësor të Kosovës, pasi që ata, deri më tani, janë sistem paralel gjyqësor dhe ne si deputetë dhe si Kuvend nuk kemi as arsye dhe as të drejtë të votojmë për gjyqtarë të tillë.

Duhet të theksoj, në mes të tjerash, se fjala është për ata që duhet ta ndajnë drejtësinë dhe është vështirë të thuhet e vërteta, por ma mirë të thuhet e vërteta këtu sesa të bartet e pavërteta. Kandidatët e propozuar, nuk i plotësojnë kriteret e

parapara me konkurs. Në mesin e tyre kemi që nuk e kanë provimin e jurisprudencës. Unë dokumentet do t'ua dhë në shiqim.

Dy. Sygjerimet nga gjykatat në Mitrovicë janë që të emërohen tjerë kandidatë, ndërsa janë propozuar krejt kandidatë tjerë.

Tre. Gjykatësit e tillë kërkojnë dokumente të shtetësisë nga Serbia, Kraleva, me datën 19.9.2003 dhe kemi vërejtje që janë dhënë, një mori vërejtjesh që janë dhënë komisionit dhe nuk dij a janë marrë në shqyrtim a jo. Unë kam konsideratë për komision, por ja ku janë vërejtjet.

Duhet të ceku edhe këtë, se këta kandidatë kanë aplikuar ligjet diskriminuese, ata që kanë diskriminuar popullin shqiptar në procese diskriminuese politike, kanë zbatuar drejtësi të pushtesit, janë të korruptuar dhe nuk gëzojnë autoritet në mesin e vet.

Dhe, e dyta, për të emëruar gjyqtarët, për ta ndarë drejtësinë në emër të popullit, ata që kurrë nuk e kanë dëgjuar zërin e popullit unë, mendoj, është vështirë dhe nuk duhet dhënë besimi sepse ne jemi përfaqësues dhe ata as që e kanë dhënë besimin asnjëri këtu para nesh. Nëse dëshironi me dokumenta dhe me emër dhe unë ua lë aty që dëshirojnë, qe te kryetari dhe lus që për kandidatët prej numrit 18 deri 23 të kërkojnë shënime plotësuese dhe sqarime. Ju falemnderit. Qe urdhëroni, materialin krejt aty është.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Halil Ahmetaj, pastaj si anëtar i Kryesisë profesor Sejdiu.

HALIL AHMETAJ:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Unë dola për të reaguuar dhe njëherit mbështes plotësisht deputetin Kelmendi dhe dola të reagoj konkretisht për një rast konkret në kreun e tretë, pika 1, për zotin Ali Uka, ish gjyqtar dhe tash punon në Gjykatën për Kundërvajtje në Gjakovë. Kandidati Aliu është i propozuar si prokuror në Prokurorinë e Qarkut në Pejë dhe si duket për këtë rast komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese nuk ka patur të dhëna të sakta për kandidatët e propozuar nga

Këshilli gjyqësor dhe prokurorial, prandaj për rastin konkret propozoj që kandidati Ali Uka, edhe një herë për këtë kandidat të kërkohen të dhëna shtesë nga Këshilli Gjyqësor dhe sigurisht se komisioni i cekur më parë do të mbështesë propozimin për kandidatin në fjalë, sepse meriton të jetë në mesin e atyre, të paktën bile edhe në mesin e të parëve që janë mbështetur nga komisioni.

Unë mund të deklarohej këtu se e njoh personalisht zotin Ali Uka si gjyqtar dhe i vetmi faj i tij është sepse ky atëherë kur është kërkuar betimi të shkohet në Beograd nuk ka shkuar dhe si pasojë i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Për të gjitha aspektet tjera i plotëson kushtet të jetë në mesin e atyre që janë përkrahur.

Unë kam dokumente dhe informacione plotësuese, të cilat janë të vërtetetuara dhe të cilat do t'ia dorëzoj Kryesisë në shiqim. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Fatmir Sejdiu dhe le të bëhet gati Bajrush Xhemajli.

FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti kryetar. Të nderuar deputetë,

Është një çështje që e kemi shtruar edhe në seancën e fundit të Kryesisë dhe besoj se do t'i përcillet edhe zotit Kadi dhe Komisionit të Këshillit Prokurorial Gjyqësor për të sjellë të dhëna të plota relevante për secilin kandidat të propozuar, duke filluar nga datëlindja dhe gjithë gjeneraliet tjera të nevojshme për t'i pasë këtu. Dhe, atëherë mund të bisedojmë me argumente – është kështu apo s'është kështu, edhe nga kundërshtimet eventuale që mund të vijnë nga deputetët.

Çështja e dytë për çka dola në këtë rast, sepse diskutimet parimore të shumicës së diskutantëve i përkrah, është një lëshim që është bërë në proces apo në raportin nga ana e Komisionit dërguar sot për shqyrtim përkatësisht për miratim nga ana e Kuvendit. Pikërisht, duke marrë parasysh disa elemente që u shtruan më herët, edhe nga diskutantë tjerë, për të dhëna të plota e të sakta dhe të dijmë se janë qytetarë të Kosovës, kanë vendbanim të Kosovës dhe proceset tjera. Në listën, në të cilën nuk është dhënë pëlqim nga ana e Komisionit, është edhe një kandidat i

katërt. Është kandidati Careviq, për të cilin – i shihni të dhënat: “Branka Careviq, diplomë universitare, referente e industrisë në Pançevë, shef i sigurimit – fabrika Pançevë, shef ligjor FAK Pançevë, deritash avokat në Beograd.”. Asnjë e dhënë tjetër që të mund t’na argumentojë se është qytetar i Kosovës nuk është e shtruar. Si të tillë e kemi refuzuar dhe duhet të ketë parasysh Sekretaria që ta ketë listën e plotë, complete ashtu siç ka vendosë Komisioni. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Udhëroni, Bajrush. Le të bëhet gati Dragisha Kërstoviq.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Kryesi e nderuar, kolegë deputetë të pranishëm në këtë sallë,

Unë mendoj se rekomandimet e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës edhe në parim janë të gabuara dhe mbi të gjitha janë të mangëta. Në qoftë se Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë dhe kornizë kushtetuese e ka patur vetëm këtë material që ne e kemi pasur në kutitë postare, mendoj që as që kanë mund të konkludojnë realisht për figurat, për kandidatët po mendoj. Ky material, në fakt, s’është kurrfarë materiali. Por, të mos flas kështu, mendoj, pa ndonjë argument, unë kam zgjedhur vetëm një kandidat kështu që ta elaboroj se çka po dojmë të a provojmë, nëse do t’kishim a provuar, e kam fjalën. Unë nuk i njoh edhe të gjithë kandidatët, por mendoj se kësi kandidatë mund të ketë shumë.

Ta zëmë, Liljana Miliçeviq, gjyqtare në Gjykatën Komunale në Ferizaj, dega në Shtërpcë – thuhet, ka punuar. Vetëm kaq, ka po mendoj në informacionin që ne e kemi. Kjo mendoj që as që ka dashur të vijë në listë, por ja ka ardhë dhe pak po e elaboroj përse nuk do të kishte qenë dashtë kështu të bëhet. Kandidatja ka punuar gjykatëse gjer në qershor të vitit 1999, kështu që, në bazë edhe të Rregullores 1199/7 neni 6.1 nën e) nuk lejohet, pasi ka punuar, qysh është e popullarizuar të thuhet – me ligjet diskriminuese. Unë s’do të thoja – vetëm me ligje diskriminuese, por me ligje antinjerëzore apo edhe antishqiptare, pse jo. Kjo është nën një.

Nën dy. Ish gjyqtare e kësaj gjykate, Liljana Miliçeviqi, edhe gjatë bombardimit të NATO-s, me rastin e daljes në vendin e ngjarjes, kanë përpiluar procesverbale, të cilat kanë të bëjnë me vrasjen e njerëzve dhe ndezjen e shtëpive, por në bazë të

atyre procesverbaleve nuk është bërë identifikimi i kufomave, është bërë varrimi i disa prej tyre pa zbatuar autopsinë dhe nuk janë sqaruar edhe fakte tjera të rëndësishme gjatë dhe pas kryerjes së vendngjarjes. Këtë e ka pasë Këshilli Prokurorial i Kosovës këtë që unë lexova, e citova, po mendoj. Dhe tash prap e ka qitë kandidat. Nuk e di në bazë të çfarë kriteri. Po them, për mua s'ka pasë kritere fare.

Pastaj, kandidatja Liljana Miliçevići, duhet theksuar, se në periudhën e pasluftës, ka punuar si gjyqtare në gjykatën ilegale apo paralele në territorin e Serbisë, e në emër të gjykatës komonale të Ferizajit duke mosrespektuar rezolutën e KSt të OKB 1244 dhe Rregulloren e PSSP, që do të thotë në fakt ka injoruar një gjykatë që po do të punojë. Deri sot e ka injoruar, dhe për të, ka qenë inekzistente dhe tash është bërë kandidate, shkon nëpër do instanca, aprovohet dhe duhet të gjykojë, aq më tepër në një vend siç është multietnik Shtërripca. Mendoj se është absurd, por që, ka kesi absurde.

KRYETARI I KUVENDIT:

Dragisha Kërstović, le të përgatitet Ymer Muhaxheri.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Poštovani predsedniče, dame i gospodo poslanici,

Jednostavno sam očekivao da neću imati ni potrebe da se javim po ovoj tački dnevnog reda i da izlazim za ovu govornicu, budući da smo u Komisiji za pravna pitanja, zakonodavstva i ustavni okvir prilično korektno odradili ovaj posao, ali budući da su ovde izrečene ocene kakve su izrečene, ja sam našao zashodno i jednostavno sam morao da izadjem i da reagujem ovom prilikom kao predstavnik Srpske zajednice. Jednostavno, ovde je izrečeno dosta paušalnih i neodgovornih ocena i to naročito... i gotovo isključivo na one kandidate koji potiču iz Srpske zajednice. Ako budemo krenuli tako kako smo danas krenuli, onda je sasvim sigurno da nećemo stići daleko i da ćemo ne tapkati u mesto nego ponovo ići u neku prošlost i imati sporove oko nekih stvari oko kojih, po mom dubokom uverenju, nema potrebe da imamo sporova. Jer su ljudi, jesu srpske sudije radile sve do 99. godine i sudile po zakonima Republike Srbije. Ja ne vidim nikakvu mogućnost da se u to vreme mogle da sude po nekim drugim zakonima i da umesto zakona primenjuju neka pravila iz, ko zna, kojih drugih pravnih izvora.

Ja zaista mislim da na ovakav način, ovakvim pristupom, mi sprečavamo otvaranje mnogih pozitivnih procesa, koji su, rekao bih već počeli, počelo je neko otoplavanje, počela je neka drugačija klima, ali na ovaj način mislim da činimo da se ti procesi zaustave i da jednostavno ne idemo napred.

Mnogi kosovski političari su..., puna su im usta onoga da se Srbi ne integrišu u kosovske institucije, da nema integracije Srba, - evo Srbi hoće da se integrišu, pokušavaju da udju u kosovsko pravosudje, neko je sada ovde, dakle najviša vlast na ovom prostoru, je protiv toga?

Najviše je prigovora bilo na Mitrovicu i na Leposavić i to isključivo na kandidate koji potiču iz Srpske zajednice. Mi ćemo na ovo uložiti jedan ozbiljan prigovor nekome; videćemo kome – šta to znači, šta znači današnje otvoreno suprostavljanje ulasku srpskih sudija u kosovsko pravosudje i kakve sve to implikacije može da ima na neke druge procese, na proces povratka, na proces slobode... na proces slobode i bezbednosti i slobode kretanja i na mnoga druga pitanja. Jer ako Srbi ne mogu da imaju sudije ili ako se svakom Srbinu jednostavno može reći – on je sudio po nekim srpskim zakonima, pa to je baš pitanje za neku ozbiljniju raspravu i mislim da ne možemo tako da pridjemo tom pitanju. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Gani Koci i fundit. Do t'ju lutem, mosni p asi ta dëgjoni dikë. Ajop na çon tjetërkah. Urdhëro Gani dhe fund i paraqitjeve tjera.

GANI KOCI:

Zoti kryetar, të nderuar kolegë,

Unë nuk do të flas kësaj radhe për kandidatët veç e veç, por do të shtroj një çështje sepse raste të tilla kemi pasë edhe më herët në dhënien e pëlqimit ose jopëlqimit për kandidatë të caktuar. Unë vetëm do të shtroja një pyetje se kush është ai këshill prokurorial dhe gjyqësor, kur është themeluar ai këshill, para kujt vendosë ai këshill dhe kujt i përgjigjet ai këshill dhe do të shtroja edhe cilësitë morale, njerëzore, politike, kombëtare të atyre njerëzve që e përbëjnë atë këshill dhe të cilët na i sjellin emrat e kandidatëve që ne të vendosim këtu. Thuhet në

popull se “si e ëma ashtu edhe e bija”. Unë e di që në atë këshill prokurorial ka njerëz, s’dua përmend me emra, por ka njerëz që me vite të tëra, me dhjetëvjetësha kanë shpallë aktgjykime politike dhe kanë dhënë me mijëra, qindra vjet dënime këtu në Kosovë. Prandaj, të shtrojmë njëherë e përgjithmonë këtu – nëse ne duhet të japim pëlqim këtu për kandidatët atëherë ne duhet të kemi edhe do ingjerenca që të ndikojmë në atë këshill prokurorial, që ai këshill prokurorial t’i përgjigjet këtij Kuvendi, që ky Kuvend të japë pëlqimin edhe për zgjedhjen e atyre njerëzve atje dhe tek pastaj ne do të krijojmë besimin e plotë të ai këshill dhe në kandidatët që do t’na i propozojë ai këshill prokurorial dhe gjyqësor. Kjo është çështja dhe këtu duhet të fillojmë e jo të merremi tash me kandidatët por me institucionin ose mekanizmin që bën për zgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Jo, shumë rrespekt por s’mundeni më... Po t’i s’mundesh në emër të Komisionit, qe Fatmiri, Kola po kërkon...

SABRI HAMITI:

Zotni kryetar, ky është funksionalizëm, jo bajraktarizëm, të lutem shumë. Shumë gabimisht e karakterizove nën një. Në dy. Këtu u tha, në emër të një grupi parlamentar një vlerësim që është shumë i gabueshëm. Dhe unë, u tha si replikë, e diskutimit të zonjës Kelmendi, ju s’po ia jepni fjalën.

KRYETARI I KUVENDIT:

S’e ka përmendur atë me emër kërkues dhe s’ka drejtë në replikë.

SABRI HAMITI:

Qysh nuk ka të drejtë!? Ka materia, të drejtë. Nuk ka nevojë emri. Ka të drejtë! Zotni thotë, që diskutimi këtu për gjyqtarët në veri të Mitrovicës, në dy komuna, po bisedohet ndërsa po artikulon qëndrim politik që kjo mënyrë e diskutimit të kualiteteve të gjyqtarëve pengon integrimin e tyre!? Përkundrazi: Kjo është mënyrë, thirrje për integrim. Sepse, përkundrazi në kuptimin politik, është thirrje

për dezintegrim nëse ne zgjedhim gjyqtarë të cilët me gjykimet e veta nuk aplikojnë ligjet e Kosovës. Pikë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Nejse, me këtë e vërtetove. Tash të qetësohemi, ju lutem. Nuk ka nevojë... Unë zonjës Kelmendi ia dhash fjalën në fillim dhe ua dhash fjalën të gjithë atyre që diskutuan. Po, po. Nuk po e përfundoj, por nuk ka nevojë të ngrisim temperaturën. I kemi argumentet dhe vendosim, në mënyrë demokratike. Prandaj, unë thash, nuk ka nevojë për sqarime sepse i ka Komisioni, ta dëgjojmë pastaj edhe ... Ti je shef i Grupit parlamentar, jo në emër të Nekibës, por në emër të Grupit Parlamentar. Urdhëroni, në emër të Komisionit.

ARSIM BAJRAMI:

Fatkeqësisht, të gjitha këto probleme që i kemi me zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve konsistojnë në faktin se kemi vetëm një rol formal në këtë proces. Dhe, mendoj se problemi është krejt se kompetenca për të zgjedhur gjyqtarë dhe prokurorë është e UNMIK-ut përkatësisht e institucionit që ai ka formuar, pra të Këshilli Prokurorial Gjyqësor për punën e së cilit këtu ka pasë vazhdimisht vërejtje saherë kemi diskutuar për zgjedhjen e prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe mendoj se këto vërejtje gjithmonë janë të arsyeshme për shkak se këta gjyqtarë, përpos anës formale të plotësisht të kushteve ligjore, duhet ta kenë edhe legjitimitetin e këtij Kuvendi, për shkak se gjykojnë në emër të popullit. Në të gjitha aktgjykimet që ata bëjnë shkruan – në emër të popullit. Në qoftë se është në emër të popullit atëherë vërtetë këtij Kuvendi duhet t'i lejohet që të ketë një ndikim dhe është plotësisht e ligjshme kërkesa që Kuvendi ta marrë këtë proces në tërësi.

Meqenëse sot patë vërejtje të argumentuara, unë dëshiroj të tërheq vërejtjen se s'kam qenë në mbledhjen e fundit të Komisionit, por kam plotësisht besim në punën korrekte të Komisionit,... meqenëse patë vërejtje të argumentuara nga disa deputetë, unë propozoj që për rastet për të cilat këtu u prezentuan prova, kishte kolegu Kelmendi disa raste, për ato raste të kërkohet një shtyrje, të kërkohen të dhëna plotësuese. Rastet tjera, unë insistoj që t'i zgjidhim. Për shkak se, mosushtrimi i kësaj kompetence, në fakt, po i jep mundësi Përfaqësuesit Special që ai pastaj t'i zgjedhë edhe ata persona për të cilët ky Kuvend ka vërejtje. Kështu që, propozoj këto raste që u përmendën këtu, të identifikohen dhe

Komisioni të kërkojë edhe zyrtarisht nga Këshilli Prokurorial dhe Gjyqësor të dhëna shtesë në mënyrë që në një mbledhje të ardhshme edhe për raste të tilla të japim rekomandime adekuate.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë desha në fund të rezymoj dhe t'ju informoj. Data e fundit për përgjegje ka qenë 6 tetor. Për shkak të rrethanave që kanë ngjarë, ne nuk kemi mund dhe kemi lutur të shtyhet deri më sot. Kjo është një konstatim dhe e mbështes plotësisht atë që tha kryetari i Komisionit.

Atë që do t'ju lutja, që është shumë e arsyeshme – vërejtjet që bëhen konkrete, duhet të argumentohen dhe të jipen me shkrim, ju lutem, në mënyrë që mos të dëmtohet edhe lista e kandidatëve të tjerë. Do të thotë ky është parim dhe po ballafaqohemi me të njëjtat probleme.

Një çështje që nuk duhet të jetë e pranueshme në Parlament, në qoftë se ndokush ka punuar në një gjyqësi të një kohe, me një ligj të caktuar, ai nuk mund të diskreditohet në qoftë se nuk e ka anashkaluar atë ligj dhe ka punuar kundër ligjit por mbi baza të vendimeve politike. Prandaj, le të arsyetohet dhe me emër e me mbiemër në mënyrë që mos ta mundësojmë që an-blok të pranohen të gjithë.

Kush është për, dhe këtu sot ne debatojmë për mendimin e Komisionit. Komisioni ka shqyrtuar shumë here këto.

Po i thash, domethënë për të gjitha rastet që kishte vërejtje konkrete, ndahen prej listës dhe për to lëhet për mbledhjen e ardhshme, por vërejtjet me shkrim ju lutem.

Kush është për, për mënyrën që për ata që nuk ka patur vërejtje konkrete t'i aprovojmë. Hajde bre Bujar, se shumë i njeh ti ja unë, një nga një. Ju falemnderit shumë.

A ka kush kundër këtij propozimi, kësaj konkluze? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? Numëroni abstenimet, ju lutem. 11 abstenime.

Pra, të rezymoj: Aprovohet propozimi i Komisionit për kandidatët që nuk ka patur vërejtje me numër dhe me emër. Për të tjerët shtyhet për mbledhjen e ardhshme, në qoftë se dokumentohet. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For Shumica – Vecina – Majority...
 - Kundër – Protiv – Against00...
 - Abstenime – Uzdrzanih – Abstained...11...
-

Dhe, për fund, kemi propozimin e rendit të ditës për seancën plenare më 16 tetor 2003.

- Shqyrtimi i dytë për inspektoratin sanitar (nuk është i gatshëm por do të shohim...); pastaj,
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit të sportit;
- Shqyrtimi i propozimit të panelit lidhur me kundërshtimin e Koalicionit “Kthimi” në Ligjin për qasje në dokumente zyrtare.

(Prej vendi, nuk dëgjohet qartë, T.Hajdaraj: Zoti kryetar, a bën një lutje. Meqenëse ligji për çështje sanitare nuk është i gatshëm; ligji për pesticidet është i amandamentuar dhe ... i dërguar... Mirë, ju falemnderit).

KRYETARI I KUVENDIT:

Të paraqiten me shkrim, por krejt çka të arrihet deri të martën në Kryesi, shkon Tomë. Ju falemnderit për pjesëmarrje. Shihemi në mbledhjen e ardhshme.

Seanca përfundoi në orën 13,00.

E transkriptoi RT (fq.1-58), Zyra E-04, Tel.211-860